

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
MASTER I ARKIVISTIKËS

Rezyme e Temës

” VEPRIMTARIA KULTURO- ARSIMORE E ARKIVAVE NË KOSOVË ”

Kandidati: Artan Hoti

PRISHTINË, 2021

Thuhet që Historia filloi me paraqitjen e shkrimit dhe të shkruarit. Nuk ka kaluar shumë kohë, kur arkivat në shumicën e vendeve evropiane, gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë u pajtuan që në radhë të parë, në mos ekskluzivisht, historia të jetë në qendrat e arkivistikës dhe dokumentet kryesisht të trajtohen si të tilla me vlerë historike. Kështu, filluan të ndajnë dokumentet me vlerë të përhershme që do të jenë në dispozicion për kërkime historike. Me krijimin e arkivave si institucione që për bazë kanë ruajtjen, përpunimin dhe mbrojtjen e dokumenteve.

Si objektivi të metodologjisë gjatë punimit të kësaj Teme kam përcaktuar atë të grumbullimit të burimeve që kërkojnë metoda të caktuara. Është praktikisht e pamundur për individin të punojë pa burime.

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “Veprimtaria Kulturo- Arsimore e Arkivave në Kosovë”. Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Punimi në fjalë përmban dy kapituj:

1. Në kapitullin e parë kemi trajtuar çështje të cilat ndërlidhen me funksionalizimin e arkivit. Në kuadër të këtij nënkapitulli, rëndësi të veçantë i kemi dhënë fillimisht zhvillimit të arkivistikës si shkencë, karakteristikat e saj, dhe sfidat të cilat janë kaluar deri në krijimin e kësaj shkençe. Ky kapitull në vete përmban plotë tre nënkapituj të cilat trajtojnë çështje që ndërlidhen me arkivistikën, ndarjen e arkivave, funksionalizimin e tyre, teksa nënkapitulli i tretë në vija të trasha trajton shkurt historikun e arkivit të Kosovës dhe arkivit të Shqipërisë.
2. Në kapitullin e dytë kemi trajtuar çështje të cilat lidhen kryesisht me zhvillimin arsimor dhe impaktin që arkivat patën në kuadër të kësaj fushe. Ky kapitull është titulluar si “Veprimtaria Kulturo-Arsimore e Arkivave në Kosovë”. Ky kapitull në vetë përmban plotë tre nënkapituj në kuadër të së cilëve trajtohen dhe studiohen çështje dhe tema të ndryshme të cilat ndërlidhen me temën bosht edhe të punimit mirëpo edhe të kapitullit në fjalë. Në kuadër të këtij kapitulli kemi trajtuar çështje si veprimtaria kulturo-arsimore e arkivave, pastaj jemi munduar që të paraqesim ekspozitat, seminarët, ligjeratat, periodikët, udhërrëfyesit dhe botimet e veçanta të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës që nga themelimi i tij e deri në ditët e sotme.

Në këtë hulumtim sa i përket metodave hulumtuese kemi përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për ta finalizuar hulumtimin në fjalë kemi përdorur metodat analitike dhe krahasimore. Studimi ynë ka për qëllim të sjell para studentëve dhe studiuesve informacione që kanë të bëjnë me *Veprimtarinë Kulturore- Arsimore të Arkivave në Kosovë*”

Po ashtu synojmë që përmes këtij punimi të Masterit, të sjellim informacione të rëndësishme mbi veprimtarinë e arkivave në Kosovë, duke konsideruar që këto informacione dhe trajtimi i këtyre çështjeve do të jetë në interesin e përgjithshëm të të gjithë studiuesve të fushave të ndryshme, pjesë e rëndësishme e të cilave është edhe arkivi.

Lidhur me temën jemi munduar të sjellim informacione të reja duke kryer hulumtime nëpër një numër të konsiderueshëm të literaturës.